

## *Arnaqia e Poshtme*



Arnaqia e Poshtme, relativisht është fshat i ri. shtrihet 5. kilometra në perendim të Shkupit, fshat i pare në dalje prej Sarajit në rrugë për Tetovë. Në vitin 1961. nga fshati i vjetër, me emrin Arnaqi, i cili shtrihet tre kilometra në jugperendim të Arnaqisë së Poshtme, u shpërngulën tre familjet e para në lokacionin e tanishëm të Arnaqisë së Poshtme.

Në vitin 1962. numri i atyre që u shpërngulën e dyfishua, në mesin e tyre ishte edhe Abdulvahit Mahmuti, vllau më i vogël i molla Mautit, imamit të Arnaqisë, përndryshe babai i Sabahudin ef. Mahmuti. Vahiti, All-llahu e mëshiroft, nga dashuria e tij ndaj fesë islame dhe besimit të paluhatshtëm, ai, një arë të veten me pozicion shumë të mirë, në mes të fshatit e la vakëf për xhami e shtëpin e tij e ndërtoi në pjesën lindore të fshatit dhe me qëllim që sa më mirë ta plotësoi obligin e tij ndaj islamit, ai të birin e vetë të dytë, Sabahudinin e regjistron në medresen e Gazi Husrevbeut në Sarajevë me qëllim që të paiset me ilm e dituri e t'i sherbej islamit në xhaminë që

shpresonte se do të ndërtohet në arën që e la vakëf për këtë qëllim, pra qëllimin e kishte të len pas veti xhami por edhe alim që do t'i shërbej islamit dhe xhamisë! All-llahu e bëft rahmet.

Në viti 1964. në moshën 52 vjeçare ndron jetë Abdulvahiti dhe nuk ariti ta sheh se si All-llahu i Madhërishëm me fuqinë e Tij i realizon njetet që janë të pastërta për All-llah. Dëshira që në arën e tij ta sheh xhaminë, sa ke gjallë nuk ju plotësu!? Jo se nuk mundnin fshatarët ta ndërtojnë, por nga fakti se sipas sistemit komunist, të asaj kohe, nuk i plotësonim kushtet për një gjë të këtillë, për shkak se fshatarët e Arnaqisë së Poshtme, xhaminë e Arnaqisë së vjetër e kanë afër! vetën 3km?! I ndjeri, poashtu, nuk ariti ta sheh as të birin e tij ta mbaroj medresen në Sarajevë e dilmë studimet e tija në istancat më të larta arsimore islame në Al-Azhar.

Në vitin 1965. fshatarët e Arnaqisë së Poshtme, e cila tani më numëronte mbi 20. shtëpi, të mësuar prej dikujt, nga organet zyrtare, kërkojnë leje për ndëtim për “Shtëpi Kulture”, me qëllim që të njejtën ta shëndrojnë, pas ndërtimit, në xhami, kështu fshatarët e Arnaqisë së Poshtme e aritën qëllimin e tyre, ju dha leja, bile edhe projektin Komuna e Karposhit ua bëni falas, u ndërto objekti dhe sipas marveshtjes sekrete mes fshatarëve, objekti, brenda natës u shëndru në xhami, por fatkeqësisht, në vend të hapjes solemne, objektin, plicija jugosllave ua mbyll me plumb, me kërcnim se kush e hapën do të përgjigjet.

Tani fshatarët e Arnaqisë së Poshtme mbetën pa xhami e pa shtëpi kulture, deri sa me rahmetin e All-llahut në verë të viti 1966. një grupë të rinjësh prej 8-9 djelmohave, të organizuar nga Sabahudin ef. Mahmuti, nxënës i medreses Gazi Husrev Beut në Sarajevë në atë kohë, e këputin plumbin dhe e hapin derën e xhamisë e cila mbeti e hapur në shërbim të islamit, deri ditën kur në temelet e saja të cekët por të bekuar, u vendosën temelet e reja, por tani shumë ma të thella, temelet e xhamisë së re të cilës paraprakisht ju krijuan kushte për të qenë jo vetëm xhami, por Qendër moderne Kulturore Islame me sipërfaqe shfrytëzuese nën mbulesë mbi 700m<sup>2</sup> e që umerua me emrin e sures 68 “El-Kalem” Falenderojmë All-llahun Fuqiplotë për pranimitë lutjes së Abdulvahitit dhe realizimin e dëshirës së tij.





Çdo besimtarë që kontriboi për ndërtimin e kësaj Qendre Islame, pamarë parasyshë llojin e dhe sasinë e kontributit All-llahu me Xhennet e shpërbleft.